

Thirrja është e hapur nga data 05.05.2026 deri më 15.05.2026

TERMAT E REFERENCËS

Kontraktimi i një kompanie profesionale për prodhimin e një video dokumentari.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI NRF: 601188700 Rr.Adnan Krasniqi nr.149 Hyrja II nr.8 Prizren.
Objektivi i thirjes	Krijimi i një dokumentari të metrazhit të shkurtër mbi ecurin dhe zhvillimin e aktiviteteve të projektit “Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës”

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimindhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumtave dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga muaji tetor të viti 2023 ka filluar të zbatojë projektin “Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Projekti po zbatohet në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

“Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës” është projekt tre vjeçarë i cili implementohet nga OJQ “Nevo Koncepti” në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe ka si qëllim kryesor fuqizimin e vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë duke u ofruar atyre njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për një tranzicion të suksesshëm në moshën madhore dhe punë dinjitoze dhe të qëndrueshme.

3. OBJEKTIVA

OJQ “Nevo Koncepti” synon të angazhojë një kompani profesionale për prodhimin e një dokumentari të metrazhit të shkurtër, i cili do të realizohet në përputhje me kërkesat dhe objektivat e përcaktuara nga organizata. Qëllimi i këtij dokumentari është të paraqesë procesin e ecurisë dhe zhvillimin e aktiviteteve të realizuara në kuadër të projektit, duke pasqyruar progresin dhe ndikimin e tyre tek grupi i synuar.

Video dokumentari do të ketë një kohëzgjatje prej 15 deri në 18 minuta dhe do të shërbejë si përmbledhje e projektit.

4. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Dokumenton në mënyrë kronologjike procesin e ecurisë dhe zhvillimit të aktiviteteve të projektit përmes xhirimeve në terren.
- Realizon intervista me përfituesit dhe akterët kryesorë për të reflektuar përvojat dhe progresin e arritur gjatë aktiviteteve.
- Përzgjedh dhe monton materialin vizual në mënyrë që të pasqyrojë qartë zhvillimin dhe ndikimin e aktiviteteve tek grupi i synuar.
- Siguron që narrativa e dokumentarit të jetë në përputhje me objektivat e projektit dhe të reflektojë rrjedhën reale të aktiviteteve.
- Koordinon me ekipin e projektit për identifikimin e momenteve kyçe që duhet të dokumentohen gjatë implementimit të aktiviteteve.
- Kryen montazhin final të dokumentarit duke integruar elemente vizuale dhe audio që paraqesin progresin dhe rezultatet e projektit.
- Bashkëngjit dhe përpunon në mënyrë profesionale fotografitë dhe videot e realizuara gjatë aktiviteteve të projektit para angazhimit të kompanisë, duke i integruar ato në dokumentar në mënyrë koherente dhe cilësore.

5. PËRVOJAT DHE AFTËSITË E KËRKUARA

Kompanitë që aplikojnë duhet të kenë përvojë të dëshmuar në realizimin e dokumentarëve të ngjashëm, si dhe të posedojnë aftësitë e nevojshme për përgatitjen dhe prodhimin e një dokumentari cilësor

Gjatë aplikimit, kërkohet të bashkëngjitet një video e shkurtër që pasqyron punën ose përvojat e ngjashme.

6. POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE

Si kusht për lidhjen e një marrëveshjeje, kompania kontraktuese duhet të nënshkru dokumentin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si politikë e organizatës kontraktuese.

7. AFATI KOHOR

Afati kohorë për përfundimin e video dokumentarin duhet të jetë jo më largë se 22.06.2026.

8. VLERËSIMI

Do të vlerësohen vetëm dokumentet e kompletuara, të dorëzuara brenda afatit dhe që ofrojnë zgjidhjen më të favorshme ekonomike, në përputhje me kërkesat e përcaktuara më sipër.

9. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë kompanitë e interesuara për aplikim duhet të ofrojnë këto dokumente:

1. Oferta financiare në emër të OJQ''Nevo Konceptit''
 - Oferta e çmimit për njësi kohe (për minutë) duke përfshirë skriptat, montazhen dhe titrat.
2. Dokumentin e ARBK-s
3. Kopja e ID-s së përfaqësuesit të kompanis.
4. Referenca të më hershme.

Ofertat duhet të dërgohet jo më largë se data 15.05.2026 në formë fizike ose përmes email prokurimi@nevokoncepti.org